



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



KOMUNA E PRISHTINËS

KRYETARI I KOMUNËS

14-352/01-0242395/17, më 27. 09. 2017

Në bazë të dispozitave të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L -040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), të nenit 37, paragrafi 2, nenit 56, paragrafi 1, nenit 77, paragrafi 1 dhe 2, si dhe nenit 91, paragrafi 1, pika 1.5 të Ligjit nr. 04/L-027, për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe nga Fatkeqësitë e tjera, të nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Komunës së Prishtinës, merr këtë

V E N D I M

- I. Miratohet Vendimi për ngritjen e shkallës së gatishmërisë emergjente në nivel Komune.
- II. Me këtë Vendim mobilizohet struktura e sistemit të mbrojtjes, shpëtimit, ndihmës dhe shërbimeve të tjera emergjente, të cilat do të merren me trajtimin e qenve endacakë për të zvogëluar rrezikun e qytetarëve, në koordinim me Komitetin e Krizave dhe organizatave që mirren me trajtimin e tyre.
- III. Për trajtimin e tyre do të angazhohen institucionet profesionale.
- IV. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Komiteti i Mbrojtjes dhe Shpëtimit.
- V. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

U dorëzohet:

- Komitetit të Mbrojtjes dhe Shpëtimit.,
- Qendrës për shërbime me qytetarë,
- Në dosje.



Kryetari i Komunës
Shpend Ahmeti